

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7916
E hënë, 28 tetor 2024
Çmimi 0.50

Kurti: Prizrenin po e bëjmë gati për UNESCO

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:


www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE



"WIR SCHAFFEN DAS": JEHU I POLITIKËS SË MERKELIT NË BALLKANIN PERËNDIMOR F. 2

MUSLIU-SHOSHI: FTOJMË ORGANET E DREJTËSISË QË TË HETOJNË AFERAT NË MPJD F. 3

U VAZHDOHET MASA E NDALIMIT DY TË DYSHUARVE PËR SULMIN NDAJ GAZMEND MUHAXHERIT F. 6

EKONOMI



GËRXHALIU: QEVERIA E KOSOVËS GODET EDHE ME NJË BARRË TË RE TATIMORE BIZNESIN KOSOVAR F. 7

MURATI: THEMELIMI I BANKËS ZHVILLIMORE NË KOSOVË PO BËHET REALITET F. 7

SPORT



FITORJA E DYTË RADHAZI PËR YLLIN, BASHKIMI TRIUMFON EDHE NË 'KARAGAÇ' F. 10

VON DER LEYEN THOTË SE DUHET ENDE PUNË PËR HEQJEN E MASAVE NDËSHKUESE NDAJ KOSOVËS

FAQE 4-5



Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, gjatë vizitës në Prishtinë, tha se duhet të punohet edhe më shumë që Bashkimi Evropian

të heqë masat ndëshkuese që ka vendosur ndaj Kosovës. Ndërkaq, udhëheqësit kosovarë kërkuar heqjen e këtyre masave. Për mua është e

rëndësishme që ta shohim Kosovën si partneren tonë dhe ta bëjmë të mundur rrugën e Kosovës drejt BE-së", tha von der Leyen

PRIORITETET E KAMALA HARRISIT DHE DONALD TRUMPIT PËR KOSOVËN NË RAST TË ZGJEDHJES PRESIDENT

F. 3

SHKRUAN: PROF. DR. FEJZULLA BERISHA



MBI 1 MIJË DIVORCE BRENDA TETË MUAJVE, TRADHTIA SHKAK KRYESOR

F. 3



RENOVA

Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501289



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com



Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË



**Kolegji
BIZNESI**

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net



INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

‘Wir schaffen das’: Jehu i politikës së Merkelit në Ballkanin Perëndimor

BLERIN, 27 TETOR - “Wir schaffen das”, apo “Ne mund ta bëjmë këtë” - ishte refren i vazhdueshëm i Angela Merkelit në vitin 2015, atëkohë kancelare e Gjermanisë. Me të, shprehte vendosmërinë e saj për t’iu hapur dyert imigrantëve - shumë prej të cilëve iknin nga lufta në Siri, e të tjerët nga Afrika e Veriut, Iraku e Afganistani.

Më 2015 dhe 2016, mbi 1.2 milion njerëz aplikuan për azil në Gjermani dhe rreth 800.000 në pjesë të tjera të Evropës, duke shënuar kështu lëvizjen më të madhe të popullsisë në kontinent që nga Lufta e Dytë Botërore.

Një studim i publikuar në korrik nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik gjeti se shkalla e punësimit të imigrantëve në Gjermani në vitin 2022 ishte 70% - dukshëm më e lartë se në shumicën e vendeve të tjera të BE-së.

Me rritjen e së djathtës ekstreme ndër vite dhe pas disa sulmeve të kryera nga imigrantë të dyshuar, Gjermania sot ka ligje më të ashpra për azilin dhe kontrole në të nëntë kufijtë e saj tokësorë.

Në margjina të një samiti të BE-së, javën e kaluar, kancelari gjerman, Olaf Scholz, tha se Qeveria e tij është duke luftuar me sukses imigracionin e paligjshëm. “Në muajt e fundit, Gjermania kishte gati 50% më pak kërkesa për azil, krahasuar me një vit më parë, dhe dëbimet vazhduan gjithashtu”, tha Scholz.

Gjermania s’është e vetmja. Kontrole në kufij vendosen edhe shtete të tjera, si Austria, Franca, Danimarka, Sllovenia etj., edhe pse bëjnë pjesë në zonën e lëvizjes së lirë, Schengen.

Si arsye, shumë prej tyre përmenden kërcënimet terroriste dhe sistemet e mbingarkuara të azilit. Polonia, në anën tjetër, paralajmëroi se do ta pezullojë përkohësisht të drejtën për azil, pasi Finlanda më herët mbylli të gjithë kufirin me Rusinë, për shkak të azilkërkuësve.

Italia, ndërkohë, zgjodhi edhe një rrugë tjetër, duke hapur dy qendra imigrantësh në Shëngjin dhe në Gjadër të Shqipërisë, në të cilat planifikon të mbajë burra që kapen në ujërat ndërkombëtare, derisa përpiqen të kalojnë nga Afrika në Evropë.

Atje do të përpunohen vetëm aplikacionet e njerëzve nga vendet që Italia i konsideron të sigurta - në total 21 syresh. Ndaj, shumica pritet të refuzohen - ata që pranohen, çohen në Itali, të tjerët riadthesohen.

Kështu kërkon marrëveshja që kryeministrja e Italisë, Giorgia Meloni, nga e djathta ekstreme, bëri me kryeministrin e

Shqipërisë, Edi Rama, vitin e kaluar.

Grupi i parë prej 16 imigrantësh arriti në Shqipëri më 16 tetor, por vetëm pas pak ditësh ata u dërguan në Itali, pasi Gjykata e Romës konstatoi se vendet prej nga vinin - Egjipti dhe Bangladeshi - nuk mund të konsideroheshin të sigurta.

Në përpjekje për ta shpëtuar marrëveshjen me Shqipërinë, Qeveria italiane e ngriti statusin ligjor të listës së vendeve të sigurta - nga dekret ministror në akt ligjor. Vendimi i Gjykatës së Romës, megjithatë, hedh dyshime mbi realizimin dhe ligjshmërinë e planeve që edhe BE-ja po i diskuton, për ndalimin e imigrantëve në qendra jashtë bllokut.

Shefja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, tha se “duhet nxjerrë mësim nga protokollin mes Italisë dhe Shqipërisë”. “Shkalla e kthimit të imigrantëve të parregullt nga vendet e BE-së është aktualisht vetëm rreth 20% - që do të thotë se shumica dërrmuese e njerëzve që urdhërohen të largohen nga një shtet anëtar i BE-së, nuk e bëjnë këtë”, shkroi von der Leyen në një letër dërguar vendeve anëtare.

Në kontekstin e planeve të BE-së për t’i dërguar imigrantët përtej kufijve, Ravenna Sohst, nga Instituti i Politikave të Migracionit në Evropë, flet për rëndësinë strategjike të Ballkanit Perëndimor: “Ballkani

Perëndimor është një grup vendesh interesante, sepse ato janë afër Bashkimit Evropian. Disa shtete anëtare kanë marrëdhënie shumë të ngushta me to. Italia e Shqipëria janë një shembull, por edhe Gjermania është e lidhur me shumë prej tyre”. “E, përveç kësaj, shtetet e këtij rajoni vijjnë në mendje edhe për shkak të aspiratave të tyre për anëtarësim në BE”, thotë Sohst për programin Expose të Radios Evropa e Lirë.

Duke ndihmuar Italinë, Qeveria në Tiranë siguron mbështetjen e saj në procesin e integritit në BE. Sohst thotë se në këtë mënyrë mund të joshen edhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, të cilat, përveç Kosovës, janë të gjitha kandidatë për anëtarësim në bllok. Eleonora Milazzo, nga Qendra e Politikave të Migracionit e Institutit Universitar Evropian, thotë se bashkëpunimi i jashtëm efektiv për menaxhimin e migracionit, kërkon përfitime të balancuara dhe gjithëpërfshirëse si për BE-në, ashtu edhe për vendet e përfshira partnere.

E pyetur nëse Ballkani Perëndimor mund të bëhet adresë për imigrantët që synojnë BE-në, Milazzo thotë: “Tash për tash,



mund të them se ka një interes të madh dhe thirrje të fuqishme për të eksploruar opsionin e ndalimit të imigrantëve dhe të përpunimit të kërkesave për azil në qendra të pritjes ose të dëbimit në vende të huaja. Kemi parë disa propozime të tilla edhe në ditët e fundit dhe rezultat i takimit të 27 liderëve të BE-së, javën e kaluar, ishte shterëngimi i politikës së dëbimit”. Në një adresim për gazetarët, javën e kaluar, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se nuk ka marrë ndonjë kërkesë për pranimin e imigrantëve, ashtu siç ka bërë Shqipëria. “Ne kemi pranuar refugjatë nga Afganistani, pas kërkesës së Shteteve të Bashkuara. Kur SHBA-ja kërkon diçka prej nesh, ne nuk e vëmë në pikëpyetje, por kërkesa të tilla nga pala evropiane nuk kemi pasur”, tha Kurti.

Kosova pranoi disa valë afganësh nga viti 2021, kur talibanët morën pushtetin në vendin e tyre.

Në maj të këtij viti, Kuvendi i Kosovës ratifikoi marrëveshjen për t’i lëshuar me qira Danimarkës një burg në qytetin e Gjilanit. Shteti danez pritet të sjellë aty rreth 300 të dënuar prej tij.

Aktualisht, burgu është në fazën e adaptimit sipas kërkesave të Danimarkës dhe më pas pritet transferimi i të burgosurve. Pasi ata ta vuajnë dënimin, do të depërtohen.

Kjo marrëveshje u nënshkrua qysh në vitin 2022 dhe ministri i Drejtësisë i Danimarkës atëkohë, Nick Haekkerup, la të kuptohej se të burgosurit që do të dërgohen në Kosovë, nuk do të jenë shtetas të Danimarkës apo të vendeve të tjera të BE-së. “Me këtë marrëveshje, Danimarka dërgon një sinjal të qartë për të huajt nga vendet e palëve të treta që janë dënuar me dëbim: e ardhmja juaj

nuk është në Danimarkë dhe për këtë arsye nuk do ta kryeni dënimin tuaj këtu”, tha Haekkerup.

Radio Evropa e Lirë pyeti Qeverinë e Kosovës se si do të procedonte nëse BE-ja ose ndonjë vend i saj anëtar do t’i kërkonte të stuhonte imigrantë të tjerë, ngjashëm si Shqipërisë, por zëdhënësi Përparim Kryeziu konfirmoi se “një kërkesë e tillë nuk ka ardhur”.

Në Qeverinë e Maqedonisë së Veriut, Bosnje e Hercegovinës dhe Malit të Zi nuk iu përgjigjën pyetjes së REL-it.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, u shpreh kategorikisht kundër në një takim që zhvilloi këtë javë me kryeministrin hungarez, Viktor Orban, dhe me kryeministrin sllovak, Robert Fico, në Komarno të Sllovakisë. “Nuk më shkon mendja dhe nuk do të pranoja në asnjë rrethanë që Serbia të bëhej vatër e nxehtë. Nuk ka dredhi dhe lojëra të tilla. Miqtë e mi nuk kërkuan, as dikush tjetër nuk mund të kërkojë, sepse nuk mendoj ta diskutoj fare”, tha Vuçiç. Gjatë krizës së vitit 2015, por edhe në vitet e mëvonshme, Serbia dhe vende të tjera të Ballkanit Perëndimor, si Bosnje e Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut, u shfrytëzuan si rrugë transite nga imigrantët për të hyrë në vendet e BE-së.

Në Organizatën Ndërkombëtare për Migrim, e cila është pjesë e sistemit të Kombeve të Bashkuara, thonë për Exposeden se menaxhimi i migrimit është një prerogativë sovraane e shteteve dhe duhet të jetë në përputhje me detyrimet sipas ligjit ndërkombëtar dhe rajonal. “Marrëveshjet jashtëterritoriale, në përgjithësi, mund të paraqesin sfida ligjore, etike dhe operationale. Ne besojmë se bashkëpunimi midis

shteteve për migrimin dhe azilin duhet të mbështetet në standardet më të larta të mbrojtjes dhe dinjitetit, sidomos për njerëzit në situatat më të cenueshme”, thotë zëdhënësi Ryan Schroeder.

Milazzo, nga Qendra e Politikave të Migracionit me seli në Firence, thotë se është e vështirë të vlerësohet efektiviteti i veprimeve të vendeve të BE-së, por thekson rëndësinë e solidaritetit dhe të ndarjes së përgjegjësive.

Ngjashëm sugjeron edhe Sohst, nga instituti me qendër në Bruksel. Sipas saj, politika e imigracionit nuk ka të bëjë vetëm me reduktimin e ardhjeve të reja. “Politika e imigracionit është shumë më e madhe. Ka të bëjë me atë se si t’i mbrojmë njerëzit në nevojë sa më shumë; si t’u përgjigjemi tregjeve të punës që kanë nevojë për punëtorë të rinj; si t’u përgjigjemi ndryshimeve demografike. Të gjitha këto janë çështje vërtet të rëndësishme me të cilat duhet të merret politika e imigracionit”, thotë Sohst.

Sipas Agjencisë Kufitare të BE-së, Frontex, numri i kalimeve të parregullta kufitare në BE, në shtatë muajt e parë të këtij viti, ra për 36%, përkatësisht në 113.400, krahasuar me vitin 2023.

Për kritikët, politika e dyerve të hapura e Merkelit ishte “marrëzi”. “Fjalët e saj nuk mund të tërhiqen. Ajo e ka përkeqësuar një problem që do të jetë me ne me vite, e ndoshta edhe me dekada”, shkroi gazeta britanike, The Spectator. Për mbështetësit, qasja e saj është një dëshmi e përkushtimit të Gjermanisë ndaj vlerave humanitare.

E, balancimi i të dyja këtyre qëndrimeve duket se do të jetë një e bëmë vërtet magjike e kohës sonë.

Musliu-Shoshi: Ftojme organet e drejtësisë që të hetojnë aferat në MPJD

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 TETOR - Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës, Ariana Musliu Shoshi, në një konferencë për medie ka ftuar organet e drejtësisë që të hetojnë urgjentisht skandalet në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, të cilat lidhen me keqpërdorimin e dokumenteve zyrtare të qytetarëve tanë dhe ndërhyrjet e saj joligjore në organizimin e zgjedhjeve të përgjithshme.

Mediat raportuan se 406 pasaporta, 165 letërnjoftime dhe 4 vendime për shtetësi të mërgimtarëve, janë humbur në postën diplomatike të Republikës së Kosovës, tenderi për shpërndarjen e të cilave ishte dhënë një kompanie me çmim shumëfish më të shtrenjtë. "Si PDK, sot kemi vetëm një kërkesë për organet e drejtësisë në Republikën e Kosovës që krahas hetimeve të tyre për hajnitë me energjinë elektrike,

krahas hetimeve për hajnitë me ambalazhuesit e ujit, atyre me rezervat shtetërore dhe kontratat njëburimore, krahas hetimeve për nepotizëm e korrupsion nëpër institucione të ndryshme publike, urgjentisht të nisë hetimet edhe në MPJD për shkak dyshimeve për keqpërdorime të shumta me dokumentet zyrtare të qytetarëve tanë dhe ndërhyrjet e saj joligjore në organizimin e zgjedhjeve të përgjithshme", ka thënë Musliu - Shoshi.

Deputetja e PDK-së ka thënë se si pasojë e këtij dështimi të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, shumë udhëtime e bashkime familjare do të shtyhen, shumë punë do të ndërpriten, shumë shpenzime të qytetarëve tanë do të bëhen, e fatkeqësisht, edhe shumë plane të tyre do të prishen. "Të risjellim në vëmendje vonesat e shumta për shkak të mungesës së materialit në fillim të mandatit qeveritar, pastaj vonesat me muaj të tërë të dërgimit të dokumenteve nëpër misionet



tona Konsullore për shkak të mos nënshkrimit me kohë të kontratave nga Ministria Gervalla Schwarz. Të dyja këto ngecje ndodhën me qëllim të aplikimit të kontratave njëburimore nga qeveria", tha Musliu - Shoshi. Deputetja e PDK-së shtoi se kjo ministri, e posaçërisht kjo ministri, gjatë këtyre katër viteve ka dëshmuar vazhdimisht se nuk është as e Jashtme, as e Diasporës, dhe as e aftë për forcuar pozicionin e shtetit tonë në botë. "Mërgatën tanë, kjo

Qeveri i do vetëm për fushatë, për vota dhe për shfrytëzim politik. Këtë e vërteton edhe skandali tjetër i cili u zbulua dje nga mediat, për ndërhyrjen e MPJD-së në organizimin e zgjedhjeve. Në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Kushtetutën e Republikës, kjo ministri ka kërkuar nga ambasadorët dhe drejtuesit e misioneve konsullore që të sigurojnë hapësira të reja për votimin e diasporës për zgjedhjet nacionale", ka thënë

ajo. Musliu - Shoshi tha se është e parë në historinë e Republikës së Kosovës që një Ministre e Punëve të Jashtme ka mandat të plotë, ndërkohë që asnjë njohje nuk i ka ardhur vendit dhe asnjë anëtarësim në organizata ndërkombëtare nuk është realizuar.

Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës, në fund të konferencës së saj, ka falënderuar të gjitha mediat dhe gazetarët në Republikën e Kosovës, të cilët, përkundër përndjekjes politike, shantazheve dhe kërcënimeve nga ana e pushtetit, po vazhdojnë ta bëjnë më profesionalizëm punën e tyre. Ndërkaq, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, deputetja Musliu - Shoshi ka dënuar sulmin ndaj Kryetarit të Pejës, Gazmend Muhaxheri dhe ka ftuar organet e drejtësisë që sa më parë të zbardhin rastin dhe të dënojnë akterët e përfshirë në këtë sulm.

Mbi 1 mijë divorce brenda tetë muajve, tradhtia shkak kryesor

PRISHTINË, 27 TETOR - Mbi një mijë qifte u divorcuan brenda tetë muajve në Kosovë. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, vetëm gjatë muajit gusht afro 140 qifte vendosën t'i ndajnë rrugët e tyre. Derisa psikologët dhe sociologët po konsiderojnë se shkak kryesor i këtij fenomeni në rritje është tradhtia në mes bashkëshortëve. Ndërkaq, është rritur numri i partnerëve që kërkojnë këshillime psikologjike përpara divorcit.

Kryetari i Shoqatës së Psikologëve të Kosovës, Ilir Havolli vlerëson shqetësues faktin e rritjes së numrit të rasteve të divorcit.

Ai potencon se mungesa e komunikimit, shkaqet ekonomike dhe tensionet familjare, janë disa nga faktorët që po shtyjnë qiftet drejt këtij



vendimi, pas tradhtisë. "Kohëve të fundit është një fenomen mjaft shqetësues rritja e numrit të rasteve të divorcit. Po ashtu, është rritur edhe numri i qifteve që kërkojnë këshillime psikologjike pikërisht për këtë arsye.

Ekzistojnë një mori faktorësh që ndikojnë në rritjen e rasteve të divorcit, duke filluar që nga mungesa e komunikimit, përkatësisht që nga rrënimi i urave të komunikimit dhe harmonisë familjare. Pastaj

shkaqet ekonomike, që është një prej kushteve që ndikon te rritja e numrit të divorceve. Pastaj janë tensionet familjare, është dhuna e rritur brenda familjes... Mund të renditet edhe një shkaktar kryesor i rritjes apo i ndikimit direkt tek divorcet, është edhe tradhtia bashkëshortore, duke pasur parasysh se individët apo qiftet kanë arritur që përmes teknologjisë të depërtojnë nëpër sferat tjera apo në ambiente të ndryshme dhe të harrojnë njeri-tjetrin", thotë Havolli.

Përveç kësaj, psikologu Havolli thekson se ngritje ka shënuar edhe numri i qifteve të divorcuara me fëmijë.

Sociologu Genc Xërxa ndër faktorë të tjerë përmend edhe infertilitetin si shkak i shkurorëzimit mes partnerëve në Kosovë.

Xërxa vlerëson se vetëdijesimi dhe emancipimi i njerëzve ka ndikuar në marrjen më të lehtë të vendimit për ndarje.

Po ashtu, edhe drejtoresha e Shoqatës për Prindër të Ndarë, Arjeta Gashi potencon se përveç tradhtisë, dhuna psikike dhe fizike përmenden ndër faktorët kryesor nga rastet që paraqiten në këtë shoqatë.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës nga muaji janar deri në gusht të këtij viti, janë shënuar 1 mijë e 103 divorce. Vetëm në muajin gusht numri i ndarjeve është 136, derisa prin Prizreni me 15 raste dhe Gjilani me 14.

Ndërkaq, në një raport të ASK-së, thuhet se gjatë tërë vitit 2023 janë shkurorëzuar mbi 2 mijë qifte, derisa Prizreni dominon me rreth 200 raste. (kp)

AKK-ja: Kontrata kolektive i kushtoi komunave më shumë se 122 milionë euro

PRISHTINË, 27 TETOR - Favorizimi nga niveli qendror i komunave me kryetarë nga partia në pushtet duke marrë më shumë mjete financiare për kokë banori, dëmet nga kontrata kolektive e tash edhe ligji aktual për ngritjen e tatimit në pronë, janë disa nga problemet kryesore me të cilat po përballen komunat e Kosovës.

Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan

Ibrahimi, thotë për KosovaPress se përgjatë këtyre viteve komunat padrejtësisht janë dëmtuar me më shumë se 120 milionë euro për kontratën kolektive, mjete të cilat kanë qenë të parapara për investime kapitale. "Komunat përgjatë këtyre viteve janë dëmtuar padrejtësisht më shumë se 122 milionë euro. Shumica absolute e këtyre mjeteve kanë qenë të parapara për investime

kapitale. Po besojmë që zgjidhja e vetme, është që nënshkruesit e kontratës kolektive, që është niveli qendror, të merr përsipër edhe barrën financiare, e jo t'ia lë komunave sikurse deri më tani. Është kërkuar që xhirologaritë bankare të komunave të mos bllokohen, në mënyrë që komunave t'u lejohet pagesa edhe për aktivitete të ndryshme", ka thënë Ibrahimi.





Von der Leyen thotë se duhet ende punë për heqjen e masave ndëshkuese ndaj Kosovës

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, gjatë vizitës në Prishtinë, tha se duhet të punohet edhe më shumë që Bashkimi Evropian të heqë masat ndëshkuese që ka vendosur ndaj Kosovës. Ndërkaq, udhëheqësit kosovarë kërkuan heqjen e këtyre masave. Për mua është e rëndësishme që ta shohim Kosovën si partneren tonë dhe ta bëjmë të mundur rrugën e Kosovës drejt BE-së”, tha von der Leyen

PRISHTINË, 27 TETOR- Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, gjatë vizitës në Prishtinë, tha se duhet të punohet edhe më shumë që Bashkimi Evropian të heqë masat ndëshkuese që ka vendosur ndaj Kosovës. Ndërkaq, udhëheqësit kosovarë kërkuan heqjen e këtyre masave.

Zyrtarja e lartë evropiane ka qëndruar në Kosovë, në kuadër të turneut të saj ballkanit. Pas takimit me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, ajo u takua edhe me kryeministrin Albin Kurti.

Gjatë konferencës të përbashkët për medie me Osmanin, Von der Leyen tha se blloku evropian ka

mirëpritur vendimin e Kosovës për hapjen e pikës kufitare në Merdarë për mallrat nga Serbia. “Është shumë e rëndësishme të punojmë së bashku, dhe ne kemi mirëpritur hapjen e kufirit dhe avancimin e përfaqësimit të Kosovës në CEFTA dhe pas kësaj duhet të punojmë për hapa të mëtejshëm në mënyrë që të arrijmë në një pikë ku mund të hiqen masat. Edhe kjo do të ndihmojë të binden shtetet anëtare, pasi siç e dini të gjitha shtetet anëtare duhet të jenë dakord për çdo hap. Ne të dyja jemi të përkushtuara të gjejmë hapat e nevojshëm për të arritur këto qëllime. Për mua është e rëndësishme që ta shohim

Kosovën si partneren tonë dhe ta bëjmë të mundur rrugën e Kosovës drejt BE-së”, tha von der Leyen.

BE-ja vendosi disa masa ndëshkuese ndaj Kosovës vitin e kaluar për shkak të rritjes së tensioneve në veriun e Kosovës, të banuar me shumicë serbe.

Ndërkaq, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se është koha e fundit që të largohen masat ndëshkuese të BE-së, duke përsëritur qëndrimin e saj se këto masa janë të padrejta. “Është koha e fundit që masat e padrejta ndaj Kosovës të largohen përfundimisht. Përveç të padrejta, këto masa po dëmtojnë qytetarët dhe kanë dëmtuar procesin e dialogut duke e bërë atë tërësisht të pabalancuar, pabarabartë dhe të pakredibilitet”.

Edhe kryeministri Kurti, sipas një postimi në X, gjatë takimit të ndarë me Von der Leyen, i kërkoj zyrtares evropiane që BE-ja të heqë “masat e padrejta” ndaj Kosovës.

Von der Leyen po ashtu përgëzoi Kosovën në punën që ka bërë në agjendën e reformave nga Plani i Rritjes i Bashkimit Evropian, duke thënë se deri para

përfundimit të vitit, Kosova pritet të përfitojë 60 milionë euro nga kjo paketë. “Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor është i planifikuar që t’i sjellë ekonomitë e rajonit më afër tregut tonë të përbashkët dhe të integrohen në tregun tonë të përbashkët. E dimë që sukcesi i madh i zgjerimit nuk janë vetëm marrëveshjet politike dhe ndarja e vlerave, por është dhe prosperiteti ekonomik që e kemi parë te shtetet që i janë bashkuar BE-së”, tha Von der Leyen. “Tashmë i kemi hapur sektorët e tregut të përbashkët për partnerët e Ballkanit Perëndimor, në mënyrë që, për shembull, kompanitë nga Kosova mund të kenë qasje në tregun e përbashkët. Për këtë arsye na nevojiten reforma që të kemi një nivel të barabartë të pjesëmarrjes. Por, këto reforma do të shoqërohen me investime shtesë evropiane”, shtoi zyrtarja e lartë evropiane.

Nga Plani i Rritjes, në total, deri në fund të vitit 2027, nëse përmbush reformat Kosova do të përfitojë 882 milionë euro, duke u bërë përfituesja më e madhe e këtij plani për kokë banori.

Osmani tha se ky plan do të ketë ndikim në zhvillimin socio-ekonomik, në hapjen e vendeve të reja të punës si dhe do të ndihmojë shtetin në rrugën drejt integritit evropian.

Zyrtarja e lartë evropiane tha se gjatë mandatit të dytë në krye të KE-së, zgjerimi i BE-së do të mbetet top-prioritet i saj.

Ajo tha se dëshiron që në të ardhmen, të gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor të jenë pjesë e bllokut evropian.

Osmani tha se në takim me Von der Leyen ka diskutuar edhe për ndikimin rus në Serbi, shtet të cilin e akuzoi se është “satelit” i Moskës. E para e shtetit tha se që kur ka nisur lufta e Rosisë kundër Ukrainës më 2022, në Serbi është rritur ndikimi rus. Sipas saj, Rusia dëshiron që të destabilizojë mbarë rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Von der Leyen, ndërkaq, tha se e shohin që Rusia po kryen sulme hibride ndaj demokracive dhe “qëllimi është që këto demokraci të destabilizohen”, duke shtuar se blloku ka mjete që ta luftojë dezinformimin dhe parandalimin e përhapjes të narrativëve të Rosisë.

Vizita e zyrtares evropiane në

Prioritetet e Kamala Harrisit dhe Donald Trumpit për Kosovën në rast të zgjedhjes president



Shkruan:
**Prof. Dr. Fejzulla
BERISHA**

Nëse shikojmë rastet konkrete të politikave të Kamala Harrisit dhe Donald Trumpit në lidhje me Kosovën dhe rajonin e Ballkanit, këto dallime bëhen më të qarta. Kamala Harris dhe mbështetja për NATO-n dhe Ukrainën. Kamala Harris, si pjesë e administratës së Bidenit, ka ndjekur një qëndrim të qartë

pro-NATO, duke e konsideruar si themelore për sigurinë globale dhe ruajtjen e stabilitetit në Evropë. Përmes kësaj aleance, Harris ka promovuar dhe mbështetur ndihmën ndaj Ukrainës në luftën kundër Rusisë, duke sinjalizuar mbështetje të qartë për vendet e tjera të rajonit që mund të përballen me kërcënime nga Rusia.

Në këtë kontekst, një presidencë e Harris do të ishte më e prirur të ofrojë ndihmë për Kosovën në rast se tensionet me Serbinë përshkallëzohen, veçanërisht duke qenë se Serbia është e lidhur me Rusinë dhe ka mbështetjen e saj ushtarake dhe politike. Qëndrimi i administratës Biden-Harris për Ukrainën sugjeron se ata do të përpqeshin ta ruanin Kosovën të mbrojtur nga ndërhyrjet serbe dhe ruse në rajon.

Gjatë mandatit të tij të parë, Trump përkrahu Serbinë dhe në deklaratat e tij midis Kosovës dhe Serbisë, mbështeti idenë... e Richard Grenellit, i dërguari i posaçëm i Trumpit për dialogun Kosovë-Serbi. Kjo ide dhe marrëveshje e mundshme ishte e diskutueshme sepse, edhe pse synonte normalizimin e marrëdhënieve, ajo do të rrezikonte stabilitetin dhe sovranitetin e Kosovës, duke mundësuar që Serbia të përfitojë një pjesë të territorit të Kosovës. Shumë kritikë vunë në dukje se një qasje e tillë do të hapte mundësi për destabilizim etnik dhe precedentë për ndryshime kufitare në Evropë. Gjithashtu, Trump kishte një qëndrim kritik ndaj NATO-s dhe kishte sugjeruar tërheqjen e ShBA-së nga kjo aleancë. Kjo ka ngjallur shqetësime për vendet e vogla si Kosova, të cilat mbështeten te

NATO për sigurinë rajonale. Një tërheqje e mundshme e ShBA-së nga NATO do të dobësonte mbrojtjen ndërkombëtare të Kosovës, duke e lënë atë më të ndjeshme ndaj kërcënimeve nga Serbia dhe Rusia.

Administrata Biden-Harris ka shprehur hapur mbështetje për sovranitetin e Kosovës dhe ka treguar një qasje më të kujdesshme ndaj Serbisë. Kjo u pa në reagimet e ShBA-së ndaj tensioneve në veriun e Kosovës, ku u shpreh mbështetje për ruajtjen e paqes dhe respektimin e institucioneve të Kosovës. Harris, si zëvendës-presidente, ka ndjekur një linjë politike të ngjashme, duke kërkuar zgjidhje që ruajnë integritetin territorial të Kosovës dhe mbështesin rolin e ShBA-së si garantuese e paqes në rajon. Në të kundërt, Trump ka pasur një qasje më miqësore me

Serbinë...

Qëndrimi i tij për të balancuar interesat e Kosovës dhe Serbisë nëpërmjet Grenellit ka krijuar një situatë ku Kosova ndiente pasiguri për mbështetjen e ShBA-së në të ardhmen. Kjo qasje e Trumpit shihet si më e favorshme për Serbinë, duke pasur parasysh edhe qëndrimet e tij të rezervuara për aleancat ushtarake ndërkombëtare.

Nëse politika amerikane ndaj Ballkanit dhe Kosovës është prioritet, Harris mund të shihet si një zgjedhje më e favorshme për Kosovën, duke qenë se mbështetja e saj për NATO-n dhe qëndrimi i qartë kundër ndërhyrjeve ruse janë të rëndësishme për stabilitetin e Kosovës. Ndërsa një presidencë e Trumpit mund të sinjalizojë më shumë fleksibilitet ndaj Serbisë dhe potencialisht më pak mbrojtje aktive për Kosovën.



Prishtinë është në kuadër të një turneu ballkanik që ajo nisi më 23 tetor në Shqipëri. Pas Shqipërisë, ajo qëndroi në Maqedoni të Veriut, Bosnjë e Hercegovinë dhe Serbi.

Në Serbi, ajo u takua vetëm me presidentin Aleksandar Vuçiq, teksa anuloi takimin me kryeministrin serb, Millosh Vuçeviq.

Zëdhënësi i KE-së, Eric Mamer, tha për Radion Evropa e Lirë se arsyeja e anulimit ishte se Vuçeviq po të njëjtën ditë ishte takuar me ministrin e Zhvillimit Ekonomik të Rusisë, Maksim Reshetnikov.

Bashkimi Evropian vazhdimisht ka kritikuar Serbinë për lidhjet e ngushta me Kremlinin, teksa Moska po vazhdon luftën

kundër Ukrainës. Beogradi po ashtu nuk pranon të rreshtohet përka BE-së, sa i përket sanksioneve ndaj Rusisë për shkak të luftës kundër Ukrainës. Ndryshe, sipas KE-së, gjatë vizitës në rajon Von der Leyen do të përqendrohet më së shumti në ndihmën që Bashkimi Evropian po u jep vendeve të rajonit për përshejtimin e

reformave dhe përgatitjeve për përparim më të shpejtë në procesin e integriteteve evropiane. Më herët, Bashkimi Evropian i miratoi agjendat e reformave të pesë vendeve të Ballkanit Perëndimor, të cilat i kanë paraqitur ato si kusht për të përfituar nga paketa e Planit të Rritjes. Më pas agjendat u votuan edhe nga KE-ja, me

përjashtim të Bosnjë e Hercegovinës.

Plani i Rritjes është në vlerë të përgjithshme prej 6 miliardë eurosh, nga të cilat, 2 miliardë do të jenë para pa kthim, ndërsa pjesa tjetër do të jetë në formë të kredive të favorshme.

Von der Leyen ka përmbyllur turneun ballkanik më 26 tetor në Mal të Zi.

Kurti: Prizrenin po e bëjmë gati për UNESCO

PRIZREN, 27 TETOR- Kryeministri Albin Kurti bashkë me ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, kanë vizituar tri shtëpi tradicionale në Prizren, të cilat janë restauruar rishtazi. "Familjet Kirajtani, Vetimi e Munik i falënderuam për përkushtimin ndaj mbrojtjes së vlerave edhe kur në të kaluarën ka munguar mbështetja shtetërore. Gjatë mandatit tonë, buxheti për

trashëgiminë kulturore është për gati katër herë më i lartë. Vetëm në Prizren kemi investuar mbi 4.5 milionë euro, që është më shumë se i gjithë buxheti i vitit 2021 për trashëgimi kulturore", ka thënë Kurti. Ai ka bërë me dije se me punën që po bëjnë sot, Qendrën Historike të Prizrenit po e bëjmë gati për ta nominuar në Listën Botërore të UNESCO-s. "Qeveria jonë ndali degradimin e

monumenteve, duke i vënë ato në shërbim të komunitetit dhe ekonomisë lokale. Pothuaj nuk ka komunë ku nuk kemi restauruar këto më shumë se tre vjet e gjysmë të drejtimit tonë. E puna vazhdon, në dhjetëra monumente, gjithandej vendit. Duke i ruajtur dëshmitë e së kaluarës, ne fuqizojmë identitetin kulturor dhe potencialin ekonomik të vendbanimeve tona", ka theksuar Kurti.



EULEX-i mirëpret nisjen e hetimeve lidhur me pretendimet për rrahjen e një qytetari në veri

PRISHTINË, 27 TETOR - Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë, EULEX, tha se mirëpret vendimin e Policisë së Kosovës për të njoftuar Inspektoratin Policor për nisjen e hetimeve lidhur me pretendimet e një qytetari në veri se është rrahur nga Policia e Kosovës.

Më 26 tetor, Inspektorati Policor bëri të ditur se ka nisur hetimet për veprimet policore, pas pretendimeve të qytetarit nga Mitrovica e Veriut, Millosh Subotiq, se ishte rrahur nga Policia e Kosovës pasi ishte dërguar në stacion policor. "Me vendosmëri, ne kërkojmë që çdo pretendim për keqtrajtim të hetohen menjëherë dhe në mënyrë efektive nga autoritetet relevante. Në këtë kontekst, sipas mandatit të EULEX-it, roli ynë është që të monitorojmë hetimet e kryera nga Inspektorati Policor i Kosovës dhe, nëse vendoset, edhe nga autoritetet prokuroriale", tha EULEX në një përgjigje dërguar Radios Evropa e Lirë.

Lidhur me pretendimet e Subotiqit, disa organizata joqeveritare njoftuan më 26 tetor për ndërprerjen e bashkëpunimit me EULEX-in derisa ky mision të mos deklarohet për këtë rast. Përmes një njoftimi, që u nënshkrua nga joqeveritare Aktiv, Nova Iniciativa Shoqërore,



Qendra për Afirmimin e Veprimeve Shoqërore, Qendra për Mbrojtjen e Kulturës Demokratike dhe Instituti për Zhvillimin Ekonomik Territorial, u tha se Policia e Kosovës është "joprofessionale".

Më 27 tetor, këto organizata reagan sërish dhe i kërkuan EULEX-it që të informojë opinionionin për hapat që ka ndërmarrë për të përcaktuar përgjegjësinë për "trajtim çnjerëzor dhe torturë në këtë dhe shumë raste të tjera që kemi parë muajve të fundit në veri të

Kosovës. "Mosveprimi dhe kalkulimi i misionit të EULEX-it në monitorimin e veprimeve të institucioneve të Kosovës në sistemin e sundimit të ligjit kontribuon në inkurajimin dhe institucionalizimin e politikës së mosndëshkimit dhe dhënies së imunitetit për individët dhe grupet brenda Policisë së Kosovës për përdorimin e forcës së tepruar kundër serbëve të Kosovës. Me heshtjen e tij, EULEX-i po bëhet bashkëpunëtor", thanë organizatat joqeveritare. Në përgjigjen dërguar REL-it,

EULEX-i tha se tortura, trajtimi çnjerëzor apo denigrues janë absolutisht të ndaluara.

Ky mision tha se ka rol monitorues dhe këshillues dhe mbetet i përkushtuar që të mbështesë institucionet e sundimit të ligjit në Kosovë në mënyrë që ato të mund të garantojnë në mënyrë efektive të drejta e të gjithëve.

Misioni i BE-së tha po ashtu se nëse përmes aktiviteteve të tij monitoruese vëren shkelje serioze, EULEX-i i adreson këto me autoritetet përgjegjëse.

Çfarë pretendon Subotiqi?

Në një prononcimi për Radion Evropa e Lirë më 26 tetor, Subotiq pretendoi se ishte rrahur në stacion policor nga policët dhe se për të mbështetur këtë pretendim kishte fotografuar dhe dokumentacion mjekësor.

Ai pretendoi se ishte arrestuar pa arsye dhe se ishte dërguar në një dhomë pa kamera, ku sipas tij, zyrtarët policorë e kishin lidhur dhe e kishin rrahur.

Por, Policia e Kosovës ka mohuar pretendimet e Subotiqit, duke theksuar se ai në orët e para të së shtunës, duke qenë nën ndikimin e alkoolit, kishte tentuar të

shkaktonte dëm në një objekt tregtar.

Policia tha se e kishte arrestuar Subotiqin dhe më pas e kishte shoqëruar në stacion policor. Pas shqiptimit të një tikete për kundërvajtje, ai ishte liruar, sipas organeve të rendit.

Kjo nuk është hera e parë që pjesëtarët e komunitetit serb ankohen për sjelljen e Policisë së Kosovës. Në mesin e muajit shtator, disa aktivistë pretenduan se Policia kishte rrahur katër të rinj nga Mitrovica e Veriut, akuzë që Policia i mohoi në atë kohë, duke thënë se ata ishin arrestuar për sulm ndaj një zyrtari.

Edhe shoqëria civile ka kohë që thotë se Policia ka "trajtim diskriminues" ndaj pjesëtarëve të komunitetit serb dhe se në disa raste ka edhe përdorimi të tepruar të forcës.

Më herët, Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës i ka thënë REL-it se janë në dijeni për ankesat e qytetarëve nga komuniteti serb sa i përket punës së Policisë dhe se janë duke bashkëpunuar ngushtë me Inspektoratin Policor të Kosovës. Nga kjo ministri kanë shtuar se janë duke bërë një fushatë për sensibilizimin e qytetarëve që rastet t'i raportojnë në Inspektorat, nëse mendojnë se Policia nuk po i trajton siç duhet.

U vazhdohet masa e ndalimit dy të dyshuarve për sulmin ndaj Gazmend Muhaxherit, Prokuroria kërkon caktimin e paraburgimit

PEJË, 27 TETOR- Prokuroria Themelore e Pejës ka kërkuar 30 ditë paraburgim ndaj dy të dyshuarve për sulmin fizik ndaj kryetarit të Pejës, Gazmend Muhaxheri.

Prokurorja e rastit, Arlinda Nallbani Gacaferri, ka konfirmuar për "Betimi për Drejtësi", e cila tha se si bazë e kësaj kërkesë është ndikimi te dëshmitarët, mundësia e përsëritjes së rastit dhe rreziku i arratisjes.

"Prokuroria Themelore në Pejë në afatin e saj ligjor ka bërë kërkesën për masën e

paraburgimit ndaj të dyshuarve. Kërkesa është bazuar në tri fazat që janë paraparë në kodin e procedurës penale si është rreziku i arratisjes, ndikimi në dëshmitarë sepse në vendin ku ka ndodhë ka shumë dëshmitarë dhe ende një pjesë nuk janë intervistuar dhe pastaj ekziston edhe rreziku se të njëjtit mund ta përsërisin veprën penale për vetë faktin se shtëpia e të dëmtuarve dhe të dyshuarve nuk është shumë në largësi të madhe. Të dyshuarit dyshohen se kanë kryer veprimet penale 'sulmi ndaj personit zyrtar' dhe

'lëndim i lehtë trupor"', ka thënë Nallbani Gacaferri. Ndërkaq, dy të dyshuarve Gjykata e Pejës ua ka vazhduar masën e ndalimit edhe për 48 orë. Këtë e ka konfirmuar për "Betimi për Drejtësi" zëdhënësja e kësaj gjykate Elzana Kastrati. Kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, ishte sulmuar fizikisht nga dy persona mëngjesin e 26 tetorit në Pejë. "Rreth orës 08:50 është sulmuar nga persona të dyshuar kryetari i Komunës së Pejës, i cili ka pësuar lëndime trupore", ka thënë për "Betimi për Drejtësi", Driton



Rugova, zëdhënës i Policisë për rajonin e Pejës.

Ai ka thënë se me urdhrë të prokurorit të dyshuarit janë dërguar në mbajtje.

Policia e Kosovës përmes raportit 24-orësh të së dielës ka njoftuar për sulmin ndaj kryetarit të Pejës, duke bërë të ditur se ende nuk dihen motivet e sulmit.

Murati: Themelimi i Bankës Zhvillimore në Kosovë po bëhet realitet

Prishtinë, 27 tetor- Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve Hekuran Murati, ka thënë se themelimi i Bankës Zhvillimore në Kosovë po bëhet realitet. Murati po merr pjesë në takimet vjetore të Bankës Botërore që po mbahen në Uashington. "Njëra nga temat e diskutuara me

Bankën Botërore gjatë takimeve vjetore në Uashington, ishte edhe mundësia e mbështetjes nga ana e tyre për themelimin e Bankës Zhvillimore të Kosovës. Mbështetja nga Banka Botërore parashihet të vijë në kuadër të projektit për avancimin e sektorit financiar në Kosovë, projekt i cili pritet

të kap vlerën rreth 50 milionë euro. Banka Zhvillimore do të mundësojë financimin e projekteve zhvillimore si dhe mbështetjen e sektorëve strategjikë siç janë energjia e ripërtërishme, prodhimi dhe eksporti, bujqësia etj. Qeveria për zhvillim të qëndrueshëm!", ka shkruar Murati në "Facebook".



Gërxhaliu: Qeveria e Kosovës godet edhe me një barrë të re tatimore biznesin kosovar

Duke filluar nga janari 2025, Qeveria e Kosovës do të trefishojë tatimin mbi pronat, duke vendosur kështu një barrë të re mbi shpatullat e bizneseve kosovare

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 TETOR- Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, ka thënë se duke filluar nga janari 2025, Qeveria e Kosovës do të trefishojë tatimin mbi pronat, duke vendosur kështu një barrë të re mbi shpatullat e bizneseve kosovare.

Ai ka thënë se ligji i ri për tatimin në pronë sjell rritje të konsiderueshme për pronat komerciale dhe ato bujqësore, duke kërcënuar rëndë sektorin privat dhe zhvillimin ekonomik të vendit. "Tatimi për pronat komerciale pritet të rritet deri në 200%, një rritje e tillë e paprecedentë do të krijojë vështirësi të mëdha për shumë qytetarë dhe biznese. Kjo rritje e tatimeve për pronat komerciale, e cila shoqërohet me një tatim progresiv që do të jetë më e lartë se sa është aktualisht, që është një goditje e rëndë për të gjitha bizneset në Kosovë. Po ashtu, ligji parashikon tatim mbi tokat bujqësore, duke e bërë situatën edhe më të rëndë për fermerët, të cilët tashmë po përballen me sfida të shumta", ka thënë ai.

Gërxhaliu ka treguar për normat e reja të tatimit mbi pronat e paluajtshme. "Pronat e vlerësuara deri në 100,000 euro: Tatimi do të jetë 0.1%. Pronat e vlerësuara ndërmjet 100,001 - 500,000 euro: Tatimi do të jetë 0.2%. Pronat e vlerësuara ndërmjet 500,001 -



1,000,000 euro: Tatimi do të jetë 0.3%. Pronat e vlerësuara ndërmjet 1,000,001 - 5,000,000 euro: Tatimi do të jetë 0.4%. Pronat e vlerësuara mbi 5,000,000 euro: Tatimi do të jetë 0.5%", ka thënë ai. Njohësi i ekonomisë ka theksuar se një nga efektet më të dukshme do të jetë rënia e kërkesës për prona, pasi tatimet më të larta do të pengojnë blerësit potencialë dhe do të shkaktojnë heshtje në investime. "Kjo do të çojë në një ngadalësim të zhvillimeve të reja në sektorin e ndërtimit dhe patundshmërisë, duke u bërë pengesë për ata që investojnë nga

diaspora. Ligji i ri mbi tatimin në pronë pritet të ketë një ndikim negativ në investimet në sektorin e patundshmërisë në Kosovë, me një rënie të mundshme prej deri në 20% vitin e ardhshëm, që do të përkthehet në mbi 100 milionë euro më pak investime. Gjatë vitit të fundit, aktivitetet e patundshmërisë në Kosovë kanë arritur rreth 600 milionë euro, duke përfaqësuar afërsisht 70% të investimeve të huaja direkte (IHD) në vend, ndërsa investimet totale në Kosovë kanë qenë mbi 880 milionë euro. Ky trend i rënies në investime do të ndikojë ndjeshëm

në zhvillimin ekonomik të vendit dhe stabilitetin e sektorit të patundshmërisë dhe sektorëve të tjerë", është shprehur Gërxhaliu. Sipas tij, po ashtu, fermerët do të përballen me rritjen e kostove operative, duke rrezikuar që të zhdukin fitimet e tyre tashmë minimale.

Gërxhaliu ka thënë se këto ndryshime do t'i pengojnë ata të përfitojnë nga subvencionet që iu janë ndarë vitin e kaluar, duke e bërë situatën më të vështirë për ta. "Mungesa e dialogut mes qeverisë dhe sektorit privat për këto ndryshime ligjore ka sjellë një

situatë kaotike në mjedisin biznesor në Kosovë. Në vend që të stimulohet zhvillimi ekonomik, në po e shohim Kosovën duke u bërë një vend të pafavorshëm për investitorët, si ata vendas ashtu edhe ata të huaj. Qeveria e Kosovës duhet të rishqyrtojë këtë ligj dhe të angazhohet në një dialog të hapur me përfaqësuesit e sektorit privat për të shmangur goditjet e mëtejshme ndaj biznesit kosovar. Kjo është një mundësi për t'u rikthyer në rrugën e zhvillimit dhe të sigurimit të një ambienti më të favorshëm për investime në të ardhmen", ka deklaruar Gërxhaliu.

Trainkos-it i shtohen tre makinistë të certifikuar nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

Prishtinë, 27 tetor- Përveç përmirësimit të resurseve teknike dhe aftësisimit të lokomotivave, Ndërmarrjes Publike Trainkos Sh.A., i janë shtuar tre makinistë të certifikuar nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave. Trainkos ka njoftuar se ky freskim i stafit do të sjell një rritje të sigurisë në

komunikacionin hekurudhor. Makinistët: Lorik Kika, Endrit Rama dhe Fatlind Bullatovci shprehën angazhimin e tyre për të shërbyer me përkushtim në Ndërmarrje, duke u zotuar se do të jenë gjithmonë në shërbim të qytetarëve. "Angazhimi i tyre tregon një përkushtim të thellë për ofrimin e

shërbimeve të sigurt dhe cilësore për udhëtarët. Me këtë staf të ri, Trainkos Sh.A., është në rrugën e duhur për të përmirësuar sigurinë e komunikacionit dhe transportit të udhëtimit me tren dhe për të rritur besimin e qytetarëve në transportin hekurudhor", ka njoftuar Trainkos.



Amerika e miliardërëve, e ndarë më dysh

Gara kokë më kokë Trump-Harris ndez dhe përçan Amerikën, por ndan edhe miliardërët amerikanë. Në mënyra ndonjëherë befasuese ose ekstreme. Më i përkushtuari është Elon Musk, i cili e mbështet ish-presidentin me dhjetëra (ndoshta qindra) miliona dollarë donacione dhe përdor rrjetin e tij, X, për ta mbështetur dhe tallur Kamala Harrisin. Elon shfaqet gjithnjë e më shpesh në skenë në mitingjet e Trump (do të jetë me të në Madison Square Garden në Nju Jork). Tim Walz (zëvendës i Harris) thotë se është ai kandidati i vërtetë si zëvendës i Donaldit, jo JD Vance.

Në skajin tjetër gjejmë Jeff Bezos, manjatin e Amazon dhe kundërshtarin e Musk që e ka tallur gjithmonë atë. Trump e ka konsideruar gjithmonë armik, veçanërisht si pronar të Washington Post, një gazetë progresive. Në të kaluarën, Bezos iu kundërvu, por disa muaj më parë ai ndryshoi tonin duke deklaruar, disa orë pas sulmit të Butler, se “Trump tregoi guxim të jashtëzakonshëm nën zjarrin e një vrasësi”.

Dhe dje, ai detyroi redaksinë e gazetës së tij të mos mbështeste Kamala Harrisin, duke thyer një

traditë që zgjat prej gjysmë shekulli. Drejtuesi i kompanisë Will Lewis flet për një kthim në origjinë duke mos dhënë indikacione politike, por shumë e shohin si dorëzimin e Bezosit ndaj kërcënimeve të Trump për hakmarrje: Washington Post vazhdon të mbështesë kandidatët për zgjedhje lokale.

Miliarderë të tjerë, dikur anti-Trump, heshtin sot: frika apo mungesa e entuziazmit për Kamalën? Kjo vlen për Warren Buffett të Berkshire, “orakullin e Omahas”, për bashkëthemeluesin e Google, Sergey Brin (8 vjet më parë “thelësisht i ofenduar nga zgjedhja e Trump”, sot hesht). Heshtin gjithashtu Steve Ballmer (ish-CEO i Microsoft) dhe Ray Dalio (kreu i Bridgewater, hedge fund më i madh në botë).

Më pas rastet kontroverse të Mark Zuckerberg (demokrati, i quajtur nga Trump si armik, tani thotë se nuk dëshiron të përfshihet në politikë dhe kur Donaldi pretendoi se themeluesi i Facebook-it i kishte thënë që nuk kishte dëshirë të votonte demokratë këtë herë, ai u kufizua me një mohim lakonik).

Jamie Dimon, bankier demokrat, në krye të gjigantes JP Morgan Chase për njëzet vjet,



kishte bërë zhurmë muaj më parë duke i ftuar njerëzit të mos shihnin vetëm aspektet negative të politikave të Trumpit. Kur ish presidenti publikoi një mbështetje të rremë në rrjetet e tij sociale, Dimon e mohoi atë, duke thënë se ai nuk mban anë (me siguri mbetet një demokrat në zemër, ashtu si edhe gruaja e tij që mbështet Kamalan).

Thuhet se Wall Street mbështet Trumpin që premton taksa më të ulëta për bizneset dhe të pasurit, por lista e donatorëve miliardërë për Kamalan, e publikuar nga Forbes është më e

gjatë se ajo e Trump (81 me 52). Dymbëdhjetë prej tyre shpjeguan në një letër zgjedhjen për demokratët: “Mbrotjtja e shtetit ligjor, stabiliteti, mjedisi konstruktiv i biznesit, më të rëndësishme se taksat”.

Në krye të fansave të Kamalës thuhet të jetë Bill Gates, i cili sipas New York Times i ka dhuruar 50 milionë dollarë, por ai nuk e konfirmon dhe shton: “Unë nuk u them të tjerëve se si të votojnë”. Sponsorë të tjerë të mëdhenj të Harris janë Reid Hoffman (LinkedIn), Reed Hastings (Netflix), Eric Schmidt

(ish-kreu i Google), George Soros dhe Michael Bloomberg. Mes miliardërëve për Harrisin edhe Taylor Swift, Bruce Springsteen, regjisori Steven Spielberg dhe ylli i basketbollit Magic Johnson.

Me Trump, përveç Musk, kreun e Blackstone Steven Schwarzman, Paul Singer i fondit Elliott, Steve Wynn, mbreti i kazinove në Las Vegas, Larry Ellison (Oracle), Roger Penske (automobila) dhe Marc Andreessen, kapitalist i madh sipërmarrës i Silicon Valley. / bota.al

“Washington Post” nuk mban anë. Revoltë në redaksi. Akuza ndaj Jeff Bezos

Vendimi i miliardërëve Jeff Bezos, pronar i Washington Post, dhe Patrick Soon-Shiong i Los Angeles Times për të mos mbështetur asnjërin nga dy kandidatët për Shtëpinë e Bardhë, edhe pse ishte bërë tashmë gati, në të dyja rastet, artikulli i redaksive të tyre në mbështetje të Kamala Harris ngjalli polemika dhe protesta nga gazetarët dhe lexuesit.

Pas publikimit të një artikulli të firmosur nga redaktori William Lewis për të dhënë lajmin dhe për të pohuar, se mungesa e mbështetjes nuk çënon vlerat e gazetës, pasi kjo ishte një traditë relativisht e kohëve të fundit (që nga viti 1976 me Jimmy Carterin) dhe është e drejtë që lexuesit të vendosin vetë, gazetarët kanë publikuar një artikull ku sqarojnë se ai që ka “bllokuar” botimin e artikullit, ka qenë pronari i gazetës (dhe Amazon) Jeff Bezos, njeriu i dytë më i pasur në botë, pas Elon Musk.

Opinionisti Robert Kagan dha



dorëheqjen: “Kushdo që është pjesë e ekonomisë amerikane sa Jeff Bezos, padyshim që dëshiron të ketë marrëdhënie të mira me këdo që është në pushtet”. Menjëherë pas njoftimit të Post, Trump priti menaxherët e Blue Origin, kompania hapësinore e Bezos e cila ka një kontratë 3.4 miliardë dollarësh me NASA-n, për të dërguar astronautët në Hënë.

Bob Woodward dhe Carl Bernstein, të cilët zbuluan skandalin e Watergate në Post, e quajtën vendimin “befasues dhe zhgënjyes”, veçanërisht që pranë zgjedhjeve.

Kolumnistët fitues të çmimit Pulitzer kanë shkruar në të njëjtën gazetë se është një gabim i tmerrshëm dhe kanë frikë për objektivitetin e gazetës në të ardhmen.

Stephen King e anuloi abonimin e tij (dhe po ashtu edhe lexues të tjerë). Protesta pati edhe në Los Angeles Times: gazetari në krye të bordit të gazetës dha dorëheqjen; por vajza e pronarit, Nika, shkruan në rrjetet sociale se është e drejtë të mos jepet miratimi “për një kandidatë që po “mbikëqyr” një luftë kundër fëmijëve” (një referencë e dukshme për Gazën).

Kamala Harris bëri bujë në mitingjet me Beyoncé dhe Michelle Obama, duke folur për të drejtën e abortit, një nga pikat e saj të forta (veçanërisht mes votueseve femra). Beyoncé ftoi amerikanët të votojnë “jo si një personazh i famshëm apo si një politikane, por si një nënë”. Por toni i Harris tregonte pak ankth: “Entuziazmi është i mirë. Por unë dua të flas për punën që duhet të bëjmë.”

Trump, me guxim, i ftoi njerëzit të “ëndrojnë gjëra të mëdha” në Michigan, ku solli në skenë

disa liderë myslimanë. Ai ishte tre orë vonës për shkak të një interviste me Joe Rogan, mbretin e podkasteve, shumë i pëlqyer nga dëgjuesit e rinj meshkuj, të cilit kandidati për Shtëpinë e Bardhë i tha se “armiku i brendshëm” në Amerikë është më i keq se diktatori koreano-verior Kim Jong-un, se do të zëvendësonte tatimet mbi të ardhurat me detyrimet, se mund të kishte jetë në Mars.

Nesër ai do të jetë në Madison Square Garden, Nju Jork, i rrethuar nga Musk dhe Robert Kennedy. Kishte kohë që donte të mbante një miting atje: është vendi ku Marilyn Monroe këndoi “Happy Birthday Mr. President” për JFK, ku Bill Clinton foli në kongresin e demokratëve të vitit 1992.

The New York Times kujton se në vitin 1939, 20 mijë filonazistë mbajtën një tubim aty. Por Trumpi e di që do jetë qendra e vëmendjes, dhe është pikërisht ajo që dëshiron. / bota.al

I pamëshirshëm dhe i dëmshëm ishte vesi im për debat, por pastaj ndërhyri mbesa ime



Nga: **Sergey MAIDUKOV**,
shkrimtar ukrainas /
The Guardian

Kam hisen time të ceneve, si kushdo tjetër. As shprehia ime për kafeinë dhe as fiksimi im i pamëshirshëm ndaj ciklit të lajmeve nuk janë tamam vese të mira, por ato ishin thjesht gjëra të vogla në krahasim me fiksimin tim për të pasur të drejtë. Më pëlqente të debatoja për gjithçka – nga ngjyra për të lyer kuzhinën deri te origjina e një thënieje të famshme, apo edhe për diçka aq të parëndësishme sa ajo se çfarë duhet të ha për darkë. Ditë a natë isha gjithmonë gati të grindesha me këdo që kishte fatin e keq të niste një bisedë me mua.

Te sfiduesit e mi përfshiheshin edhe fëmijët e mi, gruaja ime, miqtë dhe madje edhe të huajt. Gjatë këtyre debateve, unë mund të ngacmoja me shaka, të kundërshtoja vullshëm, apo edhe të sillesha në një mënyrë shpërfillëse superiore. Por, e vërteta ishte se unë kurrë nuk e dëgjoja me të vërtetë këndvështrimin e personit tjetër. Për ndonjë arsye të panjohur, gjithmonë e konsideroja argumentin tim më

kompetent dhe përpiqesha ta vërtetoja në çdo mënyrë të mundshme.

Fiksimi im për të pasur të drejtë ka qenë një shtyllë në jetën time dhe shpesh ka shkaktuar telashe në familjen time; kishte momente kur martesja ime u tensionua dhe fëmijët e mi u distancuan. Lufta më e gjatë që pata ishte me prindërit e mi dhe ajo zgjati për gati një vit. Edhe mosmarrëveshjet e vogla kishin prirje të shpërthenin. Kur përpiqesha të ruaja gjakftohtësinë, humbja durimin nga nervozizmi. Nuk e besoja se veset e vjetra janë kaq të qëndrueshme. Vesi im dukej i pavdekshëm. I përrjetshëm.

Por, një pasdite me mbesën time – rreth 70 vjet më e vogël se unë – m'i hapi sytë ndaj ndikimit që sjellja ime kishte te njerëzit përreth meje. Ishim duke luajtur një lojë kur ajo bëri një lëvizje që thyente rregullat. E korrigjova, por ajo vazhdoi duke bërë të njëjtin gabim përsëri. I lexova rregullat me zë të lartë dhe e pyeta nëse i kishte kuptuar këtë herë. Ajo më buzëqeshi dhe tundi kokën. “Gjysh, pse i zmadhon gjërat?” – pyeti ajo. “Është thjesht një lojë. Jemi këtu për t'u argëtuar, apo jo?”

Diçka te fjalët e saj pati vërtet

ndikim tek unë. Nuk ishim aty për të pasur të drejtë; ishim aty për t'u kënaqur – se kur do të hidhnim zarin ose si do të lëviznim figurat, këto gjëra ishin thjesht dytësore. Ajo që kishte vërtet rëndësi ishte lidhja jonë dhe momentet që ndamë së bashku.

Disa ditë më vonë, djali im erdhi për darkë. Gjatë vaktit, ai dha një pikëpamje që më dukej e pabazë, në mos absurde. Zakonisht, unë do ta kisha futur veten fund e krye në një debat të ashpër me të, gjithmonë duke u ndier në fund fajtor që isha kokëfortë. Por, këtë herë, kur lëvizja buzët për t'u përgjigjur, kuptova se e mbusha pirunin me ushqim dhe e futa në gojë, duke e shijuar në heshtje. Fjalët e mbesës sime më jehonin në mendje – ishim mbledhur për t'u argëtuar, apo jo? Vërtet, a ia vlente të prishja mbrëmjen vetëm për të vërtetuar mendimin tim? Maturia ime më befaso. Por, ajo që me të vërtetë më mahniti, teksa e dëgjoja, ishte dëshira ime për ta kuptuar. Kjo përvojë më solli një gëzim që tejkalonte shumë kënaqësinë kalimtare të fitores në një debat.

Kur i analizoj gjërat, e kuptoj se dëshira ime për të fituar nuk

kishte lidhje me kërkimin e së vërtetës, por me dëshirën për të treguar se isha më i mirë se të tjerët. Doja që njerëzit të më shihnin si njeriun më të zgjuar, më të aftin në dhomë, dhe duke thënë gjithmonë fjalën e fundit unë ndjeja se po i vërtetoja gjërat. Ajo që kuptova ishte se sjellja ime kishte efektin e kundërt. Nuk fitoja respekt apo vlerësim duke qenë kokëfortë. Duke lëshuar pe, fitova shumë më tepër sesa duke reaguar.

Dhe, sa më shumë që e ushtroja këtë, aq më mirë e zotëroja artin e heshtjes. Ajo që nuk mund ta kisha parashikuar kurrë ishte sa do të përmirësohej lumturia ime e përgjithshme – thjesht duke dëgjuar me qetësi të tjerët, pa i ndërprerë dhe pa u bërë tepër emocional. Të mësosh të frenosh muskulin e gjuhës, nuk do të thotë se tani pranoj në mënyrë pasive mendimin e të gjithëve. Por, më ka mësuar të kem një tolerancë të re ndaj dallimeve. Në fund të fundit, askush nuk më detyron të tund kokën në shenjë miratimi për çdo deklaratë. Kur nuk jam i pajtimt me dikë, një ngritje e thjeshtë e supeve ose një përgjigje neutrale si “Kush e di? Ndoshta?” mund të kryejë gjithashtu punë.

Nuk mund të pretendoj se e kam arritur përsosmërinë. Herë pas here ndiej ende një valë të njohur acarimi që vlon, e cila ka potencialin të prishë strategjinë time të maturisë. Por, si me të gjitha gjërat e vështira në jetë, këmbëngulja është çelësi. Sapo kuptova se mund të bëja ndryshime në kontrollin e sjelljes sime, fillova të vërej të gjitha fushat e tjera të jetës që mund të përfitonin nga një akordim i mirë – si të blija një xhemper të ri dhe të vëreja papritur se pjesa tjetër e gardërobës kishte nevojë për rifreskim. Pirja e tepërt e kafesë dhe çajit ishte një nga veset që nuk kishin më efekt tek unë. Sepse, sapo qetësova streset e konflikteve me të dashurit, kuptova se nuk kisha më të njëjtën dëshirë për kafeinë.

Tani e kuptoj se të grindesh në tryezën e darkës është si të zgjedhësh të pish një filxhan kafe ose një gotë verë më shumë, ose të kalosh një orë shtesë (ndonjëherë dy ose tri) në mediat sociale. Këto janë çështje të vetëdisiplinës dhe asgjë më shumë. Në teori, gjithmonë e kam kuptuar këtë koncept, por u desh ndërhyrja e një shtatëvjeçareje që ta zbatoja. Në fund të fundit, ne jemi këtu për t'u argëtuar, apo jo? /Telegrafi/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON Inveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kualifikim historik i Rahovecit

RAHOVEC, 27 TETOR - Rahoveci ka arritur sukses historik, pasi për herë të parë ka kaluar kundërshtar në garat evropiane. Në kuadër të rrethit të dytë të Kupës Evropiane për hendbollistë, Rahoveci e eliminoi skuadrën belge, Sezoens Achilles

Bocholt. Të shtunën në palestrën "Mizahir Isma" në praninë e 2 000 shikuesve dhe në atmosferë madhështore, Rahoveci mposhti Bocholtin me rezultat bindës, 37:25. Ndeshjen e parë në Belgjikë e kishte ftuar Bocholti me tri gola dallim, 32:29.

Para tifozëve të tyre rahovecasit kanë dominuar plotësisht. Ndeshjen e nisën me seri 4:0 dhe më pas kanë mbajtur epërsinë deri në fund. Pjesa e parë përfundoi 16:13 për Rahovecin. Në pjesën e dytë dallimi ishte edhe më i madh.

Egzon Gjuka i shënoi 10 gola për Rahovecin. Tetë i kishte Jon Muqolli e pesë Victor Alonso. Me nga 4 gola kontribuan Alban Haziri e Arbios Mushkolaj. Rahoveci për herë të dytë paraqitet në gara evropiane. Herën e parë kishte luajtur dy



ndeshje të forta, por ishte eliminuar. Tani e pret shortin për kundërshtarin e rundit të tretë.

Fitorja e dytë radhazi për Yllin, Bashkimi triumfon edhe në 'Karagaç'

"Epoka e re"

SUHAREKË, 27 TETOR - Në një ndeshje mjaft dramatike, Golden Eagle Ylli ka shënuar fitore dramatike ndaj Proton Cable Prizrenit me rezultat 83:79 (21:16, 19:18, 22:26, 21:19), në javën e shtatë të ProCredit Superligës së Kosovës në basketboll. Takimi ka qenë interesant nga fillimi deri në fund, dhe me shumë kthesa, derisa përfundoi me fitoren e therandasve. Çereku i parë ishte i baraspeshuar, por katër pikë radhazi nga vendasit, bën që kjo pjesë të përfundojë 21:16. Në periudhën e dytë, prizrenasit avancuan në 21:24 me tetë pikë radhazi, por sërish u kundërpërgjigjën vendasit që kishin deri në gjashtë pikë epërsi, për të shkuar në pushim me

rezultat 40:34. Edhe pjesa e dytë ishte e ngjashme me shumë rikthime, por asnjëra skuadër nuk arrinte të shkëputej, kurse në çastet vendimtare, vendasit ishin më të vëmendshëm dhe fituan 83:79, që ishte fitorja e dytë radhazi nën drejtimin e Endrit Elshanit. Te vendasit disa basketbollistë dhanë ndihmë kyçe në këtë fitore, kurse u dalluan Terrell Brown me 24 pikë dhe Gëzim Morina me 16 pikë, pesë kërcime e katër asistime, ndërsa te mysafirët u dalluan Lenzella Smith me 17 pikë e nëntë kërcime dhe Jordan Johnson me 18 pikë e dhjetë asistime. Golden Eagle Ylli ka katër fitore e tri humbje, derisa Proton Cable Prizreni dy fitore e pesë humbje. Ndërsa Bashkimi ka shënuar fitoren e radhës ndaj Pejës me rezultatin 66:71 (26:11, 13:26, 18:19, 9:13) në kuadër të



javës së shtatë të ProCredit Superligës. Ndeshja u hap me një fillim të mirë nga ekipi i Pejës, i cili kishte një seri prej 26:11, por

Bashkimi u përgjigj në periudhën e dytë me një seri të ngjashme, duke e mbyllur pjesën e parë me rezultat të barabartë 39:39. Në çerekun e tretë, Bashkimi kaloi për herë të parë në epërsi me 48:50 dhe e përfundoi atë me një avantazh minimal prej 1 pikë, 57:58. Çereku i fundit ishte vendimtar ku edhe vendosi epilogun e kësaj ndeshje. Më të dalluarit për Bashkimin ishin Lejson Zeqiri me 18 pikë, 5 kërcime dhe 2 asistime, si dhe Samir Zekiqi me 13 pikë, 4 kërcime dhe 2 asistime. Ndërsa për Pejën, më i miri ishte Tristan Ipke me 5 pikë, 4 kërcime dhe 3 asistime, ndërsa Shahada Wells kontriboi me 10 pikë, 6 kërcime dhe 3 asistime. Bashkimi ka një bilanc të 100% me 7 fitore në 7 ndeshje, ndërsa Peja ka arritur vetëm dy fitore dhe pesë humbje.

Suhareka fiton ndaj Prishtinës, barazim mes Malishevës dhe Dritës



SUHAREKË, 27 TETOR - Dy ndeshjet e fundit të xhiros së dhjetë të Albi Mall Superligës së Kosovës në futboll u zhvilluan të dielën, e ku Suhareka fitoi ndaj Prishtinës në një duel dramatik deri në fund, derisa përballja ndërmjet Malishevës dhe Dritës u mbyll pa fitues. Pas disfatës së javës së kaluar ndaj Ballkanit, Suhareka e gjeti fitoren në shtëpi ndaj Prishtinës, me rezultatin 2:1. Mevlan Zeka zhblokoi rezultatit në minutën e 3-të. Prishtina reagoi në minutën e 30-të, kur mbrojtësi

Ardi Ajdini shënoi golin e barazimit për 1:1. Megjithatë, vendasit rikthyen epërsinë në minutën e 68-të, kur Liridon Fetahaj realizoi gol përmes një soloaksioni, duke ia siguruar Suharekës fitoren. Në minutat shtesë të ndeshjes, Prishtina kishte një mundësi të artë për ta barazuar rezultatit, por Albin Krasniqi dështoi nga pika e bardhë. Pas kësaj fitoreje, Suhareka ka arritur në kuotën e 16 pikëve dhe renditet në vendin e katërt, ndërsa Prishtina ka po ashtu 16 pikë, duke

zënë vendin e tretë. Në ndeshjen tjetër, Malisheva dhe Drita ndanë pikët, pasi përfunduan pa gola në një përballje ku rastet e shënimit ishin të pakta. Drita mbeti me një lojtar më pak që nga minuta e 81-të, pas përjashtimit të Blerton Shejtit pas dy kartonëve të verdhë. Pas këtij barazimi, Malisheva qëndron në pozitën e dytë me 18 pikë, aq sa ka edhe Ballkani në pozitën e parë, derisa Drita renditet në pozitën e pestë, me 15 pikë, por me dy ndeshje më pak të zhvilluara.


Tetë gola në derbin Inter - Juventus

Milano, 27 tetor - Interi dhe Juventusit zhvilluan një triler të vërtet, duke barazuar me rezultat 4-4 në xhiron e nëntë të Serie A. Loja nisi më mirë për Interi që arriti të fitojë penallti që në start, pasi Danilo pengoi në zonë Marcus Thuramin. Nga pika e bardhë doli të jetë i saktë Piotr Zielinski që shënoi për 1-0. Por

Juventusit u kthye shpejt në lojë, fal një aksioni të bukur, ku Weston McKennie asistoi te Dusan Vlahovic që shënoi për 1-1. "Zonja e Vjetër" nuk u ndal me kaq, duke marr epërsinë menjëherë pas barazimit, me Francisco Conceicaoon i cili asistoi te Timothy Weah që shënoi na afër për 2-1. Që kjo

ndeshje do të ishte e madhe u kujdes, Henrikh Mkhitarjan që shënoi për 2-2. Menjëherë pas golit, gjyqtari Marco Guida, akordoi penalltinë e dytë për Interin, ku sërish Zielinski ishte i saktë për 3-2. Jo vetëm pjesa e parë, por edhe e dyta ishte shumë e fortë dhe me gola. Fillimisht në start Interi, arriti të dyfishojë

epërsinë me golin e Denzel Dumfries në minutën e 53-të kur shënoi për 4-2. Por klubi më i madh italian nuk u dorëzua, ndërsa në lojë futi Kenan Yldin, i cili hapi ndeshjen në minutën e 71-të kur shënoi për 4-3. "Zonja e Vjetër" mori frenat e lojës në dorë, duke vazhduar të sulmonte dhe kjo iu shpërblye,



pasi që Kenan Yildiz shënoi golin e dytë personal për 4-4. Interi mbetet i dety me 18 pikë, ndërsa Juventusit është i tretë me 17 pikë.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit, lidhur me nenin 29.2 të Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2024 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr.1666 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita: Auditor junior për auditim financiar dhe pajtueshmëri
Numri i referencës: AJAFP/ZKA/10-13/24
Grada: ZKA-Z4
Numri i pozitave: Tre (3)
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndihmon UE në mbledhjen e informatave paraprake për auditimet ku angazhohet, për përgatitjen e dosjeve të auditimit dhe punë tjera në lidhje me auditimin;
- Shkrimi i letrave të punës së auditimit të qarta për çështjet e trajtuara dhe sipas standardeve të ZKA-së dhe të njëjtat i dorëzon me kohë të UE;
- Indeksi i letrave të punës për temat (mostrat) dhe fushat e audituara dhe të gjitha dokumentet (edhe ato që merren në Entitete) duhet të jenë në pajtueshmëri me formatin dhe kërkesat e përcaktuara nga metodologjia, që t'i mundësojë UE një rishikim me të lehtë;
- Përfundimi me kohë i letrave të punës, memove të komponentëve dhe të gjitha detyrat sipas kërkesave të UE për t'i arritur planet kohore të aprovuar nga menaxhmenti;
- Ofron bashkëpunim dhe informata të sakta për Ekipin e auditimit, departamentin e tij dhe me të gjithë sektorët dhe departamentet e tjerë në kuadër të ZKA-së;
- Ndihmon stafin tjetër të ekipit dhe të departamentit, rreth punëve audituese, për përdorim të teknologjisë informative, ofron përkrahje UE dhe të jetë përgjegjës në ushtrimin e detyrave për realizimin e objektivave të ekipit dhe të departamentit;
- Komunikim të mirë me anëtarët e ekipit me UE, DD, stafin e ZKA dhe me stafin e entiteteve gjatë auditimit;
- Të ruajë dhe azhurnojë njohuritë profesionale dhe teknike dhe të tregojnë gatishmëri për të marrë njohuri të reja nga fusha e auditimit për fushat e dakorduara me UE dhe DD gjatë vlerësimit të performancës për vitin e kaluar, dhe të ndjekë trajnimet e organizuara nga ZKA që lidhen me Edukimin e Vazhdueshëm Profesional;
- Tregojnë integritet të lartë dhe vepron në pajtim me Kodin Etik dhe të Mirësjelljes Profesionale, si brenda ashtu edhe jashtë ZKA-së;
- Kryen edhe detyra tjera profesionale që mund të kërkojnë nga UE dhe DD i/e tij.

Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, në auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë, janë:

- Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomik, juridik, administratë publike, matematikë financiare në banka dhe sigurime ose Inxhinierisë;
- Përvoja profesionale: Dy (2) vite përvojë pune profesionale në auditim, kontabilitet, financa ose administratë;
- Certifikimi: Të ketë certifikatë si teknik kontabilitetit, asistent-auditor i sektorit publik ose auditor i brendshëm.

Shkathësitë e kërkuesve:

- Njohuri në fushën e auditimeve;
- Shkathësi në organizim të punës dhe përmbushje të objektivave;
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Njohuri për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi motivuese, dhe komunikuese në ekip;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

Informata të përgjithshme për kandidatët:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomën e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- certifikatë për teknik kontabilitetit, asistent-auditor i sektorit publik ose auditim i brendshëm;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **12.11.2024 ora 16.00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U prilog članu 15.2 Zakona br. 05/L-055 za Generalnog Revizora i Nacionalnu Kancelariju za Reviziju Republike Kosovo, kao i članove 5, 6 i 7 Uredbe (NKR) 01/2024 o Prijemu i Karijeri u Nacionalnoj Kancelariji Revizije u vezi sa čl. 29.2 Uredbe (NKR) 03/2024 o Klasifikaciji Radnih Mesta; Godišnji Plan Zapošljavanja za 2024. godinu kao i Odluku Generalne Revizorke pod brojem 1666 za ispunjavanje upražnjene radnog mesta, Nacionalna Kancelarija Revizije objavljuje:

KONKURS

Za ispunjavanje slobodnog radnog mesta

1. Pozicija: Junior revizor za finansijsku reviziju i uskladenost

Referentni broj: AJAFP/NKR/10-13/24
Rang: NKR-Z4
Broj pozicija: Tri (3)
Trajanje imenovanja: Neograničeno

Dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže VT u prikupljanju preliminarne informacije za revizije u koje se angažuje, za pripremu revizorskih dosijea i druge poslove vezane za reviziju;
- Pisanje jasnih revizijskih radnih dokumenata za razmatrana pitanja i u skladu sa standardima NKR i dostavlja ih na vreme VT;
- Indeksiranje radnih dokumenata za teme (uzorke) i revidirane oblasti i svi dokumenti (čak i oni koji se tiču entiteta) moraju biti u skladu sa formatom i zahtevima definisanim metodologijom, kako bi se VT omogućilo lakši pregled;
- Blagovremeno završavanje radnih dokumenata, memoranduma o komponentama i svih zadataka u skladu sa zahtevima VT za postizanje vremenskih planova odobrenih od strane menadžmenta;
- Pruža saradnju i tačne informacije za Revizorski tim, njegovog odeljenja i sa svim drugim sektorima i odeljenjima u okviru NKR;
- Pomaže drugom osoblju tima i odeljenja, u poslovima revizije, za korišćenje informacionih tehnologija, pruža podršku VT i odgovoran je u izvršavanju zadataka za realizaciju ciljeva tima i odeljenja;
- Održava dobru komunikaciju sa članovima tima sa osobljem VT, DD, NKR i osobljem entiteta tokom revizije;
- Održavati i ažurirati stručno i tehničko znanje i pokazati spremnost za sticanje novih znanja iz oblasti revizije za oblasti dogovorene sa VT i DD tokom evaluacije učinka za prethodnu godinu i pohađati obuke koje organizuje NKR u vezi sa kontinuiranim stručnim obrazovanjem;
- Pokazuje visok integritet i postupa u skladu sa Kodeksom etike i profesionalnog ponašanja, kako unutar tako i van NKR;
- Obavlja druge profesionalne poslove koje može zahtevati VT i njegov/njen DD.

Opšti formalni uslovi za ovu radnu poziciju, u finansijskoj reviziji i reviziji uskladenosti, su:

- Obrazovanje: Fakultet ekonomije, prava, javne uprave, finansijska matematika u bankarstvu i osiguranju ili Inženjering;
- Profesionalno iskustvo: Dve (2) godine profesionalnog radnog iskustva u oblasti revizije, računovodstva, finansija ili administracije;
- Sertifikacija: Da poseduje sertifikat računovodstvenog tehničara, pomoćnika revizora u javnom sektoru ili internog revizora.

Potrebne veštine:

- Znanje iz oblasti revizije;
- Veština u organizovanju rada i ispunjavanju ciljeva;
- Poznavanje pravnih akata primenljivih kod Nacionalne Kancelarije Revizije;
- Poznavanje efektivnog nadzora profesionalnog rada;
- Sposobnost zastupanja i zaštite interesa institucije i njenog integriteta;
- Motivacione i komunikacione veštine u timu;
- Poseduje dobre međuljudske veštine.

Opšte informacije za kandidatë:

Određivanje plate vrši se u skladu sa važećim zakonima.

Postupak prijave: Postupak prijave je otvoren za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i kandidatima iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati moraju dostaviti potrebnu dokumentaciju, i to:

- službeni obrazac NKR-a za prijavu;
- kopiju lične karte Republike Kosovo;
- dokaz o školskoj spremi (fakultetska diploma). Diplome dobijene van Kosova moraju biti nostrifikovane;
- sertifikat za računovodstvenog tehničara, pomoćnika - revizora iz javnog sektora ili interne revizije;
- dokaz o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Dokaz o radnom odnosu, uz dokaz iz Trusta);
- potvrdu iz suda da nije pravosnažno osuđivan (ne stariji od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog funkcionera (ako se primenjuje);

U obzir će se uzeti samo zvanični obrazac za prijavu. Dokumenti dostavljeni nakon roka neće se razmatrati, a nepotpuni će biti odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u elektronskim medijima (online) i na internetskoj stranici Nacionalne Kancelarije Revizije. Zadnji rok za predaju dokumentacije je dana **12.11.2024 u 16.00h**.

Obrazi za prijavu mogu se dobiti na recepciji NKR-a, ili se mogu preuzeti sa web stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i predati Odeljenju za administraciju dokumenata na adresi: Naselje Arberia, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00 časova, obrazac i prateća dokumentacija se mogu dostaviti i putem imejla na adresu rekrutimi@oagks.org ili putem pošte. Za detaljnije informacije možete nas kontaktirati na tel. 038/606-004, lokal 1025.

Napomena:

Prijave poslate poštom, koje nose poštanski pečat pošiljke poslate poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se važećim i biće razmatrane.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare, lidhur me nenin 29.3 Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2024 si dhe Vendimit të Auditorit të Përgjithshëm me Nr.1666 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita:	Auditor junior për auditim të performancës
Numri i referencës:	AJAP/ZKA/10-14/24
Grada:	ZKA-Z4
Numri i pozitave:	Dy (2)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen auditime sipas planit vjetor, rregullave dhe metodologjisë së ZKA-së, Kodit të Etikës dhe në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe raporton Drejtorit të Departamentit të Auditimit dhe udhëheqësit të ekipit të auditimit;
- Kryen hulumtime dhe analizë për fushën të caktuar dhe bën propozimin e temave audituese për planifikimin strategjik dhe atë vjetor të ZKA-së; (nën mbikëqyrje nga UEA);
- Pjesëmarrje aktive në parastudim të auditimit në fusha të caktuara dhe deleguara nga UEA;
- Ofron përkrahje profesionale duke kryer hulumtime dhe analiza të të dhënave të mbledhura dhe prezantimin e tyre;
- Mbajta e shënimeve dhe dokumentimi i intervistimit dhe gjetjeve tjera;
- Nxjerrja konkluzioneve dhe dhënia e rekomandimeve duke u mbështetur në dëshmitë audituese dhe në bazë të gjyqimit profesional;
- Përgatitja e Letrave të punës me kohë së bashku me dëshmitë përkatëse dhe memo përmbledhës lidhur me auditimin e komponentës, fushës apo pyetjeve audituese, e cila i është caktuar;
- Indeksimi i letrave të punës dhe diskutimi me Udhëheqësin e tij/saj;
- Raportimi i vazhdueshëm të mbikëqyrësi lidhur me progresin e arritur në auditim;
- Aplikimi i punës online sipas kërkesave dhe udhëzimeve në nivel të zyrës për situata të caktuara;
- Kryen edhe detyra të tjera profesionale të kërkuara nga UEA dhe nga Drejtori i departamentit.

Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, në auditimet e performancës janë:

- Arsimiti: Diplomë fakulteti në ekonomi, juridik, administratë publike, shkencë politike, shëndetësi, komunikimit ose inxhinierisë;
- Përvoja profesionale: Dy (2) vite përvojë pune profesionale në hulumtim, analiza, financa ose auditim;
- Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

Shkathësitë e kërkuara:

- Njohuri në fushën e auditimeve;
- Shkathësi në organizim të punës dhe përbushje të objektivave;
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Njohuri për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi motivuese, dhe komunikuese në ekip;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomati e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (*nëse aplikohet*);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (*online*) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **12.11.2024 ora 16.00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U prilog članu 15.2 Zakona Br. 05/L-055 za Generalnog Revizora i Nacionalnu Kancelariju Revizije Republike Kosovo, kao i članova 5, 6 i 7 Uredbe (NKR) 01/2024 o Prijemu i Karijeri u Nacionalnoj Kancelariji Revizije u vezi sa čl. 29.3 Uredbe (NKR) 03/2024 o Klasifikaciji Radnih Mesta; Godišnjeg Plana Zapošljavanja za 2024. godinu kao i Odluku Generalne Revizorke pod Nr.1666 za popunjavanje upražnjenog radnog mesta, Nacionalna Kancelarija Revizije objavljuje:

KONKURS

1. Pozicija:	Junior Revizor za reviziju učinka
Referentni broj:	AJAP/NKR/10-14/24
Rang:	NKR-Z4
Broj pozicija:	Dve (2)
Trajanje imenovanja:	Neograničeno

Dužnosti i odgovornosti:

- Vršiti revizije u skladu sa godišnjim planom, pravilima i metodologijom NKR, Etičkim kodeksom i u skladu sa Međunarodnim standardima revizije i izveštava Direktora Sektora za reviziju i vođu revizorskog tima;
- Vršiti istraživanje i analizu za zadatu oblast i predlaže teme revizije za strateško i godišnje planiranje NKR (pod nadzorom VR);
- Aktivno učestvuje u pred-studijama revizije u određenim oblastima delegirane od strane VT ;
- Pruža stručnu podršku kroz istraživanje i analizu prikupljenih podataka i njihovu prezentaciju;
- Vođenje beleški i dokumentovanje intervjuja i drugih nalaza;
- Donošenje zaključaka i davanje preporuka na osnovu revizorskih dokaza i na osnovu profesionalnog prosudivanja;
- Blagovremena priprema Radnih Dokumenta zajedno sa relevantnim dokazima i rezimeom memoranduma koji se odnosi na reviziju komponente, oblasti ili pitanja revizije koja su mu dodeljena;
- Indeksiranje radnih dokumenata i razgovor sa njegovim/njenim menadžerom;
- Kontinuirano izveštavanje nadzornika o napretku postignutom u reviziji;
- Primenjivanje onlajn rada prema zahtevima i uputstvima na nivou kancelarije za određene situacije;
- Obavlja i druge profesionalne poslove koje zahteva NKR i Direktor Odeljenja.

Opšti formalni uslovi za ovo radno mesto, u reviziji učinka, su:

- Obrazovanje: Diploma fakulteta ekonomije, prava, javne administracije, političkih nauka, zdravstva, komunikacija ili inženjeringa.
- Profesionalno iskustvo: Dve (2) godine profesionalnog radnog iskustva u istraživanju, analizi, finansijama i reviziji;
- Poželjno je poznavanje engleskog jezika.

Potrebne veštine:

- Istaknuto znanje iz oblasti revizije;
- Veština u organizovanju rada i ispunjavanju ciljeva;
- Poznavanje pravnih akata koji se primenjuju u Nacionalnoj Kancelariji Revizije;
- Poznavanje efektivnog nadzora nad stručnim radom;
- Sposobnost zastupanja i zaštite interesa institucije i njenog integriteta;
- Motivacione i komunikacione veštine u timu;
- Poseduje dobre međuljudske veštine.

Opšte informacije za kandidate:

Određivanje plate vrši se u skladu sa važećim zakonima.

Postupak prijave:

Postupak prijave je otvoren za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i kandidatima iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati moraju dostaviti potrebnu dokumentaciju, i to:

- službeni obrazac NKR za prijavu;
- kopiju lične karte Republike Kosovo;
- dokaz o školskoj spremi (Fakultetska diploma). Diplome stečene van Kosova moraju biti nostrifikovane;
- dokaz o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Potvrda o radnom odnosu, uz dokaz iz Trusta);
- potvrda iz suda da nije pravosnažno osuđivan (ne starije od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa javne funkcije (ako se primenjuje);

U obzir će se uzeti samo zvanični obrazac za prijavu. Dokumenti dostavljeni nakon roka neće se razmatrati, a nepotpuni će biti odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u elektronskim medijima (*online*) i na internetskoj stranici Nacionalne Kancelarije Revizije. Zadnji rok za predaju dokumentacije je dana **12.11.2024 u 16.00h**

Obrasci za prijavu mogu se dobiti na recepciji NKR-a, ili se mogu preuzeti sa web stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i predati Odeljenju za administraciju dokumenata na adresi: Naselje: Arberia, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Prishtina, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00 časova, obrazac i prateća dokumentacija se mogu dostaviti i putem imejla na adresu rekrutimi@oagks.org ili putem pošte. Za detaljnije informacije možete nas kontaktirati na tel. 038/606-004, lokal 1025.

Napomena:

Prijave poslate poštom, koje nose poštanski pečat o pošiljci poslatoj poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se važećim i biće razmatrane.

THIRRJE PËR APLIKIM

Kompania "Bregu Com" Sh.p.k. kërkon një ofertues/kontraktor apo kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për furnizime si më poshtë:

1. Rrotoballer PS 1210 Classic - Dimenzionet e ballës 120x 120 cm
2. Makinë për mbeshtjelljen e ballove te barit me najlon-Sipma.
2. Rimorkio për shpërndarjen e plehut FIMAX 8t
3. Plugj 3 rendor
4. Kosë me pjator
5. Grabujë mbledhëse dhe shkepëse të barit
6. Panela solar me kapacitet 6kWp

Kompanitë e interesuar duhet të kontaktojnë direkt te përfituesi "Bregu Com" sh.p.k. nëpërmjet e-mailit apo telefonit, për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë.
Ftesat për Kuotim mund të merren deri me 4 Nëntor 2024

Përfituesi: Kompania "Bregu Com" Sh.p.k

Adresa: Ratishë e Ulët, pn-Deqan, Republika e Kosovës

Telefoni: +383(44) 716 149

E-maili: bregucomshpk@gmail.com

Ofertat/propozimet duhet të dorëzohen tek adresa e përfituesit më së largu deri me 11 Nëntor 2024

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT**SWISS
TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](https://www.instagram.com/lumesdetails)

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 të sh.m.m. "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Ideal Hana nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Labinot Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, salon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





TRADITË QË NGA

1992

